

ALFAZED SH.P.K

Pasqyrat Financiare Individuale

31 Dhjetor 2023



ALFAZED SH.P.K

*Pasqyrat Financiare Individuale
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023*

ADRESA
*Sheshi 11 “Austria”,
Tiranë, Shqipëri*



PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE	6
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	7
PASQYRA E LËVIZJEVE TË KAPITALIT	8
SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE	9-20



ALFAZED sh.p.k

NIPT-I_J82229006N

Bilanci Kontabël më 31 Dhjetor 2023

Shënim : Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë përveçse kur thuhet ndryshe

		31 Dhjetor	
	Shënimi	2023	2022
AKTIVET			
A. Mjete Monetare dhe ekuivalentet e tyre	3.1.1	441,824	(359,320)
1- Mjete monetare në arke		-	0
2- Llogari administrative pranë bankave		441,824	-359,320
B. Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregëtim			
C. Aktive të tjera financiare afatshkurtra	3.1.2	11,948,756	13,283,335
1- Klientë		11,173,928	12,202,213
2-Debitorë të tjerë		-	0
3- Të drejtat ndaj shtetit (tatim fitimi)		178,428	484,722
4- Të drejta për arkëtimin e shitjes së AAGJ-M		596,400	596,400
5- Të drejtat ndaj ortakëve		-	0
D. Inventari	3.1.3	-	1
1- Lëndët e para		-	-
2- Prodhim në proces		-	-
3- Produkte të gatshme		-	-
4- Mallra për rishitje		-	1
5- Parapagesa për furnizime		-	-
E. Aktive biologjike afatshkurtra		-	-
F. Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-	-
1- Shpenzime për tu shpërndarë			
I.TOTALI AASH		12,390,579.85	13,234,978
A. Investimet financiare afatgjata	3.1.5	60,676,774	60,676,774
1- Aksione të shoqërive të kontrolluara		60,676,774	60,676,774
B. Aktive afatgjata materiale neto	3.1.4	224,727,022	227,709,037
1- Makineri dhe pajisje pune neto		27,543,217	29,423,261
2- Mjete transporti neto		6,623,874	8,279,841
3- Pajisje zyre dhe informatike neto		8,091,738	8,091,738
4- Aktive në proces (Investimi i parë)		78,723,949	78,723,949
5- Rindërtimi (si aktiv në proces)		103,744,244	103,190,248
C. Aktive afatgjata jomateriale	3.1.5	17,340,336	17,340,336
1-Studim, projektim ambienti		17,340,336	17,340,336
D. Aktive të tjera afatgjata	3.1.5	-	-
1- Shpenzime për tu shpërndarë		-	-
II.TOTALI AAGJ		302,744,132	305,726,147
AKTIVET GJITHSEJ (I+II)		315,134,712	318,961,125

DETYRIME

A. Furnitorë	3.1.6	25,856,291	35,009,081
B. Detyrime ndaj personelit	3.1.7	2,469,527	3,783,235
1- Paga të pagueshme		2,451,327	3,710,435
2- Personeli-detyrime të tjera		18,200	72,800
C. Detyrime për sigurime	3.1.7	98,520	394,744
1- Detyrime për sig. shoqërore		98,520	394,744
2- Detyrime për sig. shëndetësore		-	-
D. Detyrime ndaj shtetit		(1,711,434)	(920,401)
1- Detyrime për tatim fitimin		0	-
2- Detyrime për TVSH-në		(1,711,434)	(920,401)
3- Tatimi mbi pagën		-	-
4- Detyrime për taksa të tjera		-	-
E. Detyrimet ndaj palëve të lidhura		1,232,800	1,232,800
1- Detyrime ndaj ortakëve		-	-
2-Kreditorë të tjerë (Garanci Qeraje)		1,232,800	1,232,800
3- Dividentë për tu paguar		-	-
I. TOTALI DASH		27,945,704	39,499,459

A. Hua afatgjata		-	-
1- Detyrime nga qiraja financiare		-	-
2- Bono të konvertueshme		-	-
B. Huamarje të tjera afatgjata (Hua Pronari)	3.1.8	214,977,881	201,834,875
C. Huamarje nga Institucionet Financiare (Kredi)		25,557,122	31,967,691
D. Provizione afatgjata	3.1.9	-	-
II. TOTALI DAGJ		240,535,003	233,802,567

DETYRIMET GJITHSEJ (I+II)	268,480,707	273,302,026
----------------------------------	--------------------	--------------------

KAPITALI

A. Fondi themeltar (kapitali I themelimit)	46,500,000	46,500,000
B. Rezervat	1,639,488	1,639,488
1- Rezerva statutore	-	-
2- Rezerva ligjore	1,639,488	1,639,488
3- Rezerva të tjera	-	-
C. Fitimi i pashpërndarë	(2,480,389)	(4,428,901)
D. Fitimi ose Humbja e vitit ushtrimor	994,906	1,948,512
III.TOTALI I KAPITALIT	46,654,005	45,659,099

Llogari Jashtë Bilancit	-	-
Të ardhura në pritje për arkëtim	-	-
Të tjera llogari angazhimesh	-	-
PASIVET GJITHSEJ (I+II+III)	315,134,712	318,961,125

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 9-19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALFAZED sh.p.k

NIPT-I_J82229006N

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023

Shënim: Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë përveçse kur thuhet ndryshe

	Shënime	31 Dhjetor	
		2023	2022
Shitjet neto		-	-
*Të ardhura te tjera (nga qeraja)		14,294,804	15,276,920
I.Totali i të ardhurave	3.2.1	14,294,804	15,276,920
Ndryshimi në gjëndjen e inventarit		-	-
Materialet e blera		-	-
Kostot e punës		2,472,660	2,553,404
- Paga personeli		2,124,000	2,190,000
- Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore		348,660	363,404
Amortizimet dhe zhvlerësimet		4,744,432	3,172,934
Shpenzime të tjera	3.2.2	4,629,952	5,798,230
II.Totali i shpenzimeve	3.2.2	11,847,044	11,524,568
Fitim/Humbja nga veprimtaria operative (I-II)		2,447,760	3,752,352
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga njësitë e kontrolluara			
Të ardhura dhe shpenzime financiare nga pjesëmarrjet			
Të ardhura dhe shpenzime financiare		1,452,854	1,803,840
* Të ardhura dhe shpenzime financiare nga investimet AGJ			
* Të ardhura dhe shpenzime nga interesi		1,452,854	1,803,840
* Fitim/Humbjet nga kursi i këmbimit		-	-
* Të ardhura të tjera financiare			
Fitimi/Humbja para tatimit		994,906	1,948,512
Shpenzimet e tatimit mbi fitimit	3.2.3	-	-
FITIMI/HUMBJA NETO NGA VEPRIMTARIA		994,906	1,948,512

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 9-20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALFAZED sh.p.k

NIPT-I_J82229006N

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Shënim: Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë përveçse kur thuhet ndryshe.

		31 Dhjetor	
	Shënime	2023	2022
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi për vitin para tatimit	3.3.1	994,906	1,948,512
Rregullime për:			
*Amortizimi i aktiveve afatgjata		4,744,432	3,172,934
*Fitim/humbjet nga kurset e këmbimit		-	-
*Të ardhurat nga Investimet		-	-
*Shpenzime për tatim fitimin kompesuar me tatimet e tjera		-	-
Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:			
Ndryshime në tepëricën e kërkesave të arkëtueshme		1,334,579	(2,663,572)
Ndryshime në tepëricën e inventarit		1	222
Ndryshime në tepëricën e llogarive të pagueshme		(9,152,790)	(7,740,821)
Ndryshime në tepëricën e detyrimeve ASH për tu paguar		(2,643,999)	(2,021,398)
Interesi i paguar		-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar			
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		(4,722,871)	(7,304,122)

AKTIVITETET INVESTUESE

Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(1,208,421)	(6,765,611)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	3.3.2	-	-
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Divident i arkëtuar		-	-
Blerja e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim		-	-
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		(1,208,421)	(6,765,611)

AKTIVITETET FINANCUESE

Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		-	0
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	0
Huamarrje afatgjata	3.3.3	6,732,437	1,529,943
Dividentë të paguar		-	0
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		6,732,437	1,529,943

Rrjedhja neto e parasë dhe ekuivalentët e saj		801,144	(12,539,789)
--	--	----------------	---------------------

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit		(359,320)	12,180,469
--	--	------------------	-------------------

MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE NË FU		441,824	(359,320)
---	--	----------------	------------------

ALFAZED Sh.p.k**Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***ALFAZED sh.p.k****NIPT-I_J82229006N****Pasqyra e lëvizjeve të kapitalit më 31 Dhjetor 2023***Shënim : Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë përveçse kur thuhet ndryshe*

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione thesari	Rezerva stat. ligj.	Fitimi i pashpërndarë	TOTALI
Pozicioni më 31 Dhjetor 2021	46,500,000	-	-	1,639,488	(4,428,901)	43,710,587
Efekti i ndryshimeve të politikave kontabël	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	46,500,000	-	-	1,639,488	(4,428,901)	43,710,587
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	1,948,512	1,948,512
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritja e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Aksione të thesarit të riblera	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2022	46,500,000	-	-	1,639,488	(2,480,389)	45,659,099
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	994,906	994,906
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritja e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Ndryshime ne fitimin e pashpërndarë	-	-	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2023	46,500,000	-	-	1,639,488	(1,485,483)	46,654,005

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 9-19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare


1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ENTITETIN RAPORTUES

Shoqëria “ALFAZED Sh.p.k” është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me vendim gjykatë nr. 20197 më 27 tetor 1998 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më 28 tetor 1998. Kapitali fillestar i themelimit të shoqërisë ishte 10,000,000 lekë i ndarë në 10,000 kuota me vlerë nominale 1,000 lekë secila. Gjatë vitit 2017, më 4 prill, kompania vendosi të rrisi kapitalin e saj me vlerën e fitimit të pashpërndarë të akumuluar nga shoqëria deri në vitin 2015. Tani më, vlera e kapitalit është 36,500,000 lekë. Po në këtë datë, u bë transferimi i plotë i zotërimit të kuotave nga Znj. Shefikat NGJELA tek Znj. Ersi NGJELA e cila është aktualisht ortakja e vetme e kompanisë. Roli i administratores së shoqërisë vazhdon të zotërohet nga Znj. Shefikat NGJELA.

Shoqëria fillimisht ka patur objekt veprimtarie importin, përpunimin dhe tregëtimin e letrës në formate të ndryshme por gjatë vitit 2005 shoqëria vendosi të ndryshojë veprimtarinë e saj duke filluar aktivitetin në fushën e Bar-Kafe-Restorant, me seli në qytetin e Tiranës, Sheshi “Austria”, Nr. 11, nën emrin : Bar-Restorant “AUSTRIA”. Ambienti ishte i ndarë në dy salla ku një prej tyre funksiononte si Bar-Kafe dhe salla tjetër ka funksionuar si night-club për një periudhë kohe e më pas ju rikthye projektit fillestar duke shërbyer si sallë restoranti nën emrin tregëtar “AUSTRIA”. Gjatë vitit 2017, nën kuadrin e rindërtimit dhe riprojektimit të sheshit “Skënderbej”, ambientet e shoqërisë ishin pjesë e projektit dhe u afektuan nga ky vendim. Pas përfundimit të rikonstruksionit të ambienteve të lokalit, lokali ju dha me qera “NONA Sh.p.k” për një periudhë 10 vjeçare. Të ardhurat e kësaj kontrate përbejnë burimin e vetëm të ardhurave të kompanisë.

2. BAZAT E PËRGATITJES DHE ZBATIMI I SKK-ve¹

Kompania “ALFAZED sh.p.k” i përgatiti pasqyrat e saj financiare, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Kompania ka adoptuar raportimin sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit siç janë të publikuara në faqen zyrtare nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Informacioni i gjeneruar është bazuar në supozimet bazë të ndërtimit të pasqyrave financiare në mënyrë që të sigurohet një pamje e vërtetë dhe e sigurtë e situatës financiare të entitetit:

a) Parimi i të drejtave të konstatuara

¹ SKK-Standartet Kombëtare të Kontabilitetit



Sipas këtij parimi, kompania ka njohur të gjitha transaksionet dhe ngjarjet në momentin kur ato ndodhin, pavarësisht momentit kur mjetet monetare apo ekuivalentet e lidhura me to arkëtohen ose paguhen. Njëkohësisht, në momentin kur transaksionet dhe ngjarjet ndodhin bëhet regjistrimi i tyre në regjistrat kontabël dhe raportohen në PF të periudhave të lidhura me to.

b) Vijimësia

PF janë hartuar duke u bazuar në supozimin se njësi ekonomike raportuese ALFAZED sh.p.k do të vijojë aktivitetin e saj edhe për një periudhë të ardhshme raportuese.

c) Kompesimi

Sipas këtij parimi, nuk lejohet kompesimi i elementëve të ndryshëm të pasqyrave financiare nëse kompesimi sjell humbje apo deformim material në informacionin e paraqitur në pasqyra. Të vetmet raste ku lejohet kompesimi i zërave të pasqyrave financiare janë:

- kur e kërkon apo e lejon një parim i stadarteve të përdorura
- kur fitimet apo humbjet që rrjedhin nga transaksione të ngjashme janë jomateriale.

Nga ana tjetër informacioni që sigurojnë pasqyrat financiare plotësojnë të gjitha karakteristikat cilësore bazë si:

a) Kuptueshmëria

Pasqyrat financiare janë të kuptueshme në lexim dhe të qarta për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme e të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

b) Rëndësia

Informacioni që sigurojnë pasqyrat financiare është material pra i rëndësishëm në vendimmarrjen e përdoruesve. Shumat jo materiale janë agreguar në një vlerë të vetme materiale.

c) Besueshmëria

Pasqyrat nuk janë prekur nga shtrembërime apo gabime materiale pasi pasqyrat janë krijuar duke u bazuar në paraqitjen besnike; përparësitë e përmbajtjes mbi formën; neutraliteti; parimi i kujdesit (parimi i konservatorizmit); plotësia.

d) Krahaseshmëria

Sipas këtij parimi, informacioni i pasqyrave financiare duhet të jetë i krahasueshëm nga një periudhë raportuese me ato paraardhëse si dhe nga një njësi ekonomike në tjetrën. Njëkohësisht kjo karakteristikë kërkon që njësia të ketë qëndrueshmëri në metodat kontabël të përdorura.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Duke qenë se objektivi i pasqyrave financiare është të japi informacion në lidhje me pozicionin financiar, me performancën dhe me ndryshimet në gjendjen financiare të një njësie ekonomike, në përputhje me standartet e kontabilitetit, kompania “ALFAZED sh.p.k” ka përpiluar respektivisht: pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e të ardhuravepërmbledhëse, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit dhe shënimet shpjeguese.

3.1 BILANCI KONTABËL

Bilanci kontabël paraqet informacion në lidhje me situatën financiare të njësisë ekonomike në një datë të caktuar. Mes klasave kryesore të tij veçojmë për të detajuar:

3.1.1 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë, llogaritë e pakushtëzuara me bankat dhe depozitat në formën e llogarive korrente pranë bankave të nivelit të dytë me qëllim administrimin e aktiviteteve operative afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër. Vlerësimi i detajuar i mjeteve monetare në arkë dhe në bankat e nivelit të dytë jepet në tabelën e mëposhtme:

Mjete Monetare dhe ekuivalentet e tyre	2023	2022	2021
1- Mjete monetare në arke	-	-	-
2- Llogari administrative pranë bankave	441,824	(48,357)	12,180,469
* në lekë (BKT)	38,170	33,358	589
* në lekë (Alfa Bank)	-	-	-
* në lekë (BKT)	12,091	0	143,017
* në lekë (Intesa Sanpaolo)	(2,108)	(2,108)	(2,108)
* në lekë (Tirana Bank)	1,159	3,159	7,959
* në lekë (Banka Popullore)	-	-	-
* në valutën Euro (Tirana Bank)	393,862	(81,339)	12,032,410
* në valutën Euro (Alfa Bank)	-	-	63
* në valutën Euro (Banka Popullore)	(1,349)	(1,428)	(1,461)
* në valutën leke (Credit Agricol)	-	-	-
Totali	441,824	(48,357)	12,180,469

(i) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Diferencat nga kursi i këmbimit njihen në fitim/humbje të periudhës në pasqyrën e rezultatit.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën Euro, të përdorur për të konvertuar zërat monetar të bilancit në LEK janë si më poshtë¹:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
EURO	103.88	114.23

Në rastin e shoqërisë “ALFAZED Sh.p.k” shuma e valutës në euro është e vogël dhe diferencat nga kursi i këmbimit janë jomateriale, për këtë arsye drejtuesit kanë gjykuar si të arsyeshme të mos i reflektojnë këto diferenca në pasqyrat financiare.

Gjendja e mjeteve monetare është reduktuar ndjeshëm pasi në fund të vitit të kaluar banka reflektonte kredinë e marrë në Tirana Bank e cila u përdor gjatë periudhës ushtrimore.

3.1.2 Vlerësimi i aktiveve afatshkurtra financiare

AASH-Financiare paraqesin të drejtat që kompania “ALFAZED sh.p.k” ka ndaj palëve të treta, prej të cilave pret një përfitim për një periudhë me pak se një vit.

¹Kurset e këmbimit janë marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë

(i) Klientët

Klientët paraqesin të drejtat që kompania ka ndaj klientëve për shitjet e mallrave, kryerjen e shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm. Vlerësimi i klientëve bëhet me çmimin e shitjes. Vlerësimi i klientëve krijohet nga klientët e krijuar si rezultat i aktivitetit aktual operativ si dhe nga klientë të mbartur prej periudhave të kaluara ku disa prej tyre i përkasin edhe periudhave kur kompania operonte në spektër tjetër operacional. Në përputhje me standardin, llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen për pjesën që konsiderohet si e paarkëtueshme duke njohur njëkohësisht edhe shpenzimet e borxhit të keq; mirëpo dukeqënëse një vlerësim i tillë do të mbivlerësonte shpenzimet dhe do të ulte rezultatin financiar të gjeneruar nga kompania, drejtuesit kanë gjykuar të mos i zhvlerësojnë llogaritë e arkëtueshme. Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar lista e klientëve aktualë dhe atyre të hershëm.

Klientët e kompanisë	2023	2022	2021	2020
1- Klientë nga aktiviteti aktual	1,646,387	2,674,672	11,100	-
<i>*Ersi Ngjela</i>	0	-	-	-
<i>*Kliente te tjere</i>	1,823,199	2,604,228	-	0
<i>*NonaUllirit</i>	-176,813	70,444	11,100	
2- Klientë nga aktivitetet e kaluara	10,123,941	10,123,941	10,123,941	10,123,941
<i>*Afërdita Elbasan</i>	72,900	72,900	72,900	72,900
<i>*Afërdita Tiranë</i>	203,700	203,700	203,700	203,700
<i>* Dita 2000</i>	4,352,064	4,352,064	4,352,064	4,352,064
<i>*ILAR</i>	3,338,178	3,338,178	3,338,178	3,338,178
<i>*MNS</i>	707,133	707,133	707,133	707,133
<i>*Planet</i>	75,170	75,170	75,170	75,170
<i>*Tipografia Ushtarake</i>	270,000	270,000	270,000	270,000
<i>*Vlora</i>	186,906	186,906	186,906	186,906
<i>*AREV</i>	596,400	596,400	596,400	596,400
<i>*Rubini</i>	321,490	321,490	321,490	321,490
Totali	11,770,328	12,798,613	10,135,041	10,123,941

3.1.4 Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Vlerësimi i AAGJ-M në hyrje, dalje dhe në datën e bilancit është bërë në përputhje me SKK 5-en dhe SKK 11-en.

Në hyrje AAGJ-M janë vlerësuar me koston e blerjes pasi njësia i ka siguruar të gjitha AAGJ-M të sajat vetëm përmes procesit të blerjes. Kosto e blerjes përfshin çmimin e blerjes plus çdo shpenzim tjetër të parimbursueshëm që nevojitet për të sjellë AAGJ-m në kushte normale të punës. Në datën e bilancit, AAGJ-M vlerësohen me koston historike. Në bilanc aktivet

paraqiten me vlerën kontabël neto e cila llogaritet si diferencë e vlerës kontabël me amomortizimin e akumuluar të aktivit dhe zhvlerësimet e krijuara nga ulja e vlerës së aktivit. Shoqëria bën veprime rregulluese duke shpërndarë kostot e blerjeve të AAGJ-M duke llogaritur shpenzimet e amortizimit për asetet e blera në periudhat e kaluara. Gjëndja e AAGJ-M në datën e bilancit është detajuar si në tabelën e mëposhtme:

Aktive Afatgjata	2023	2022	2021	2020
1- Makineri dhe pajisje pune (Vl. Kontabël)	44,608,488.00	43,400,067.00	36,634,456.00	36,634,456.00
*Amortizimi i akumuluar Mak_Pajisje	(17,065,271.00)	(13,976,806.00)	(12,803,827.00)	(10,216,378.00)
2- Mjete transporti (Vl. Kontabël)	22,496,112.00	22,496,112.00	22,496,112.00	22,496,112.00
*Amortizimi i akumuluar Mjete trans.	(15,872,238.00)	(14,216,271.00)	(11,758,114.00)	(9,527,696.00)
3- Pajisje zyre dhe informatike (Vl. Kontabël)	8,424,154.33	8,424,154.33	8,424,154.33	8,424,154.33
*Amortizimi i akumuluar Pajis_zyre_info	(401,884.00)	(401,884.00)	(401,884.00)	(401,884.00)
4- Mobilie dhe Orendi (Vl. Kontabël)	83,750.00	83,750.00	83,750.00	83,750.00
*Amortizimi i akumuluar Mobilie dhe Orendi	(14,282.00)	(14,282.00)	(14,282.00)	-14282
5- Aktive të patrup. Jo-Materiale (Vl. Kontabël)	17,382,372.00	17,382,372.00	17382372	17382372
*Amortizimi i akumuluar	(42,036.00)	(42,036.00)	(42,036.00)	(42,036.00)
Totali	59,599,165.33	60,000,701.33	64,818,568.33	64,818,568.33

AAGJ-M kur del nga njësia, çregjistrohet dhe bashkë me të çregjistrohet çdo llogari tjetër e lidhur me aktivin në fjalë. Një AAGJ-M bëhet dalje nëse shitet, këmbëhet apo del jashtë përdorimit. Gjithsesi, në të gjitha rastet çregjistrimi bëhet me vlerën fillestare të aktivit, bashkë me të mbyllet edhe llogaria e amortizimit dhe zhvlerësimit të akumuluar. Për rrjedhojë vlera neto kontabël (VNK) njihet si shpenzim periudhe. Nga ana tjetër njihen edhe të ardhurat nga shitja e aktivit në vlerën e çmimit të shitjes. Kuptohet që diferenca midis çmimit të shitjes dhe VNK sistemohet në rezultatin e periudhës si fitim ose si humbje në varësi të rastit.

(i) Shpenzimet pas hyrjes së AAGJ-M

Një shpenzim i mëpasshëm kapitalizohet vetëm kur është e mundur që kompanisë “ALFAZED sh.p.k” t’i rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike. Për rrjedhojë këto shpenzime do të kapitalizohen në vlerën e aktivit afatgjatë material për të cilin kryhen dhe do të shpërndahen në periudhat e ardhshme përmes amortizimit. Riparimet dhe mirëmbajtjet e vazhdueshme njihen si shpenzime periudhe kur ato ndodhin dhe sistemohen në pasqyrën e rezultatit.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është procesi i shpërndarjes së kostos së blerjes së AAGJ-M në periudhat e ardhshme ku aktivi do të kontribuojë në gjenerimin e të ardhurave. Njësia amortizon aktivet për jetën e tyre të dobishme pavarësisht jetës së tyre ekonomike. Shpenzimi i amortizimit është shprehja në vlera monetare e pjesës së konsumuar të aktivit gjatë një periudhe kontabël.

Shpenzimet e amortizimit njihen si shpenzim në pasqyrën e rezultatit. Njësia “ALFAZED Sh.p.k” ka përcaktuar si metodë amortizimi, metodën e cila aplikon % e amortizimit mbi vlerën e mbetur të aktivitetit. Kjo mënyrë krijon përputhje të shpenzimeve të llogaritura prej kompanisë me shpenzimet e njohura prej organeve tatimore. Konkretisht normat e përdorura të amortizimit janë:

- Ndërtesa- 5% në vit
- Kompiutera dhe sistemet informatike- 25% në vit
- Të gjitha AAGJ-M -20% të vlerës së mbetur

Gjatë kësaj periudhe kontabël kompania ka vendosur mos ti amorizojë asetet e veta duke konsideruar se ato për shkak të aktivitetit të kufizuar operacional që kompania ka patur, nuk kanë mundur të kontribuojnë në gjenerimin e të ardhurave.

3.1.5 Aktive afatgjata jomateriale, neto dhe të tjera

Aktivitet afatgjata jomateriale janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtuara për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t’ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative . Shoqëria ka kontabilizuar në formën e AAGJ-JM, Studimet e projektimit për rikonstruksionin e hapsirave të ambjenteve të lokalit në vlerën 17,382,372 lekë.

Gjithashtu, kompania zotëron tituj pronësie mbi kompaninë “Birra Tirana sh.a” në vlerën 60,676,774 lekë. Titujt e zotëruar janë në nivel pjesëmarrjeje.

3.1.6 Furnitorët

Detyrimet ndaj furnitorëve janë detyrime tregëtare të cilat lindin gjatë kryerjes së aktivitetit kryesor të njësisë ekonomike dhe që lindin si rezultat i blerjes së mallrave me pagesë të mëvonshme. Shoqëria ka detyrime ndaj furnitorëve në masën 12,917,835 lekë, të cilat i përkasin periudhës raportuese. Pjesa tjetër prej 12,938,456 lekësh janë detyrime të hershme të njësisë të krijuara në periudhat kur njësia operonte në një aktivitet totalisht të ndryshëm nga ky aktual te cilat u likujduan nga pronari por u kontabilizuan si nje rritje ne fitimin e pashperndare. Më poshtë jepet një paraqitje e detajuar e furnitorëve kryesorë me vlerësimet e detyrimeve që kompania ka respektivisht ndaj secilit prej tyre:

Furnitorët e kompanisë	2023	2022	2021	2020
1- Furnitorë nga aktiviteti aktual	12,917,835	22,070,625	29,811,446	29,573,564
<i>*Partia Socialiste e Shqipërisë</i>	400,000	7,250,000	5,250,000	5,000,000
<i>*NIKEJS</i>	(680)	(680)	(680)	(680)
<i>* Digi Print AL</i>	-	-	-	-
<i>*Pajtoni</i>	5,501,373	5,501,373	5,501,373	5,501,373
<i>*Dardan Ndertim</i>	0	-	-	-
<i>*Ujësjetllës Kanalizime</i>	0	-	-	-
<i>*Fero Line</i>	2,362	2,362	2,362	2,362
<i>*GSM KLIMARE(Firme kondicionimi)</i>	(25,328)	(25,328)	(25,328)	(25,328)
<i>*Tartari Glass</i>	(922,821)	(984,498)	(999,325)	(987,207)
<i>*ALBAMER</i>	(1,729,105)	(1,729,105)	10,354,895	10,354,895
<i>*FUSHA shpk</i>	3,473,615	3,473,615	3,473,615	3,473,615
<i>*ALBANTIC</i>	(371,130)	(371,130)	(371,130)	(371,130)
<i>*SHPRESA.AL</i>	0	-	-	-
<i>*Furnitorë të tjerë</i>	6,589,549	8,954,017	6,625,665	6,625,665
2- Furnitorë nga aktivitetet e kaluara	12,938,456	12,938,456	12,938,456	12,938,456
<i>*ALBIX</i>	6,167,900	6,167,900	6,167,900	6,167,900
<i>* Albanian Consortium</i>	4,050,000	4,050,000	4,050,000	4,050,000
<i>*SLS-Sarandë</i>	2,720,556	2,720,556	2,720,556	2,720,556
Totali	25,856,291	35,009,081	42,749,902	42,512,020

3.1.7 Detyrime ndaj personelit (Paga neto dhe kontributet)

“ALFAZED Sh.p.k” gjatë vitit 2023 ka patur të punësuar 3 punonjës me të cilët kompania realizon aktivitetin e saj. Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të siguruar kufijtë ligjorë për këto kontribute në Shqipëri, në bazë të skemës së kontributeve të përcaktuara dhe kompania i zbaton ato. Kontributet e kompanisë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ngarkohen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve kur ato ndodhin.

3.1.8 Huamarrje Afatgjatë

Për të krijuar vijimësi në aktivitet, gjatë kësaj periudhe ushtrimore, shoqëria është financuar me kapital të jashtëm apo me financim nga bankat e nivelit të dytë me një kredi në shumën 191,000 EUR të disbursuar në 31 Dhjetor 2018 e cila është përdorur kryesisht për shlyerjen e detyrimeve të furnitorit. Në 31 Dhjetor 2021 kompania iu aprovua një kredi nga Tirana Bank në vlerën 265,000 EUR e cila u përdor për të mbyllur kredin në Fondin Besa dhe për të shlyer detyrimet e furnitorëve, specifikisht AlbaMer.Si dhe kredi Fondi Besa në vitin 2023 euro 35000

3.1.9 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkohej një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin.

Më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2023 nuk kanë ndodhur ngjarje të tilla ndaj nuk është njohur provigjon në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.2 PASQYRA E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE

Pasqyra e të ardhurave siguron informacion të nevojshëm për gjykimin e performancës të njësisë ekonomike. Njësia ka ndërtuar PASH-in duke u bazuar në metodën e cila i klasifikon shpenzimet sipas natyrës së tyre pavarësisht se për çfarë destinacioni janë përdorur ato.

3.2.1 Të ardhurat

Bazuar në parimin e të drejtave të konstatuara, njësia ka njohur të ardhurat të cilat janë krijuar nga aktiviteti operativ i kompanisë (të ardhura qeraje) në vlerën **14,294,804** lekë.

3.2.2 Shpenzimet

Shpenzimet që janë të paraqitura në PASH, janë të klasifikuara sipas natyrës. Në zërin e shpenzimeve të tjera përfshihen zërat e paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Shpenzime qiraje	3,000,000
Shpenzime uji dhe drita	-
Shpenzime transporti	-
Blerje të pastokueshme (materiale e furnitura)	-
Sherbime të ndryshme dhe bankare	22,087
Shpenzime telefoni e postare	173,820
Shpenzime për taksa	100,100
Shpenzime për riparim-mirëmbajtje	-
Shpenzime për penalitete e gjopa	121,686
Shpenzime për mirëmbajtje dhe riparime	1,032,500
Shpenzime të ndryshme	179,759
Totali i Shpenzime të tjera	4,629,952

Për kalkulimin e tatimit fitimit, aplikimi i normës së tatimit mbi fitim (15%) u aplikua mbi fitimin e tatueshëm i cili u kalkulua si axhustim i fitimit kontabël me të ardhurat dhe shpenzimet e panjohura.

Llogaritja e fitimit për efekte fiskale

Fitimi/Humbja para tatimit	994,906
(+) Shpenzimet e panjohura	121,686
* Shpenzime page me arke	-
* Shpenzime gjorash dhe penalitetesh	121,686
* Sistemimet e vleresimit tatimor	-
* Shpenzime përmbartimi	-
(-) Të ardhurat e panjohura	-
Fitimi i tatueshëm	1,116,592
Tatim fitimi i llogaritur(15%)	167,489

Shuma që axhuston fitimin kontabël janë shpenzimet për gjoba e penalitete në vlerën 93,447 lekë të cilat përbejnë një shpenzim të panjohur për instancat fiskale.

3.3 PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Pasqyra e flukseve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike raportuese gjatë periudhës kontabël. Këto flukse raportohen në pasqyrën e flukseve monetare të klasifikuara sipas qëllimit si për shembull, fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit, e investimit ose e financimit. Pasqyra e flukseve monetare ka si qëllim kryesor dhënien e informacioneve për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre të arkëtuara dhe të paguara nga një njësi ekonomike gjatë një periudhe ushtrimore.

3.3.1 Aktivitetet operative

Shuma e fluksit të mjeteve monetare që krijohet nga veprimtaritë operative është një element kyç për të vlerësuar shkallën në të cilën veprimtaria e njësisë ekonomike ka prodhuar flukse të mjaftueshme mjetesh monetare për të ripaguar huatë, për të mbajtur kapacitetin e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, për të paguar dividendët dhe për të bërë investime të reja pa përdorur burime të jashtme financimi.

Për të llogaritur flukset monetare që gjeneron njësia ekonomike ekzistojnë dy metoda: ajo direkte dhe indirekte. Shoqëria “ALFAZED sh.p.k” përdor metodën indirekte të përlllogaritjes së flukseve. Kjo metodë nisët nga fitimi para tatimit dhe shton shpenzimet jomonetare siç është amortizimi dhe zbret të gjitha të ardhurat jomonetare. Pas kësaj, fitimi i regulluar modifikohet me ndryshimet e gjendjeve të llogarive të aktiveve dhe detyrimeve afat-shkurtra duke mbajtur në konsideratë faktin që një rritje e aktiveve është një fluks dalës kurse një rritje e detyrimeve është një fluks hyrës.

3.3.2 Aktivitetet investuese

Paraqitja veçmas e flukseve monetare që vijnë nga aktivitet investuese është e rëndësishme sepse flukset monetare përfaqësojnë madhësinë e shpenzimeve të bëra për burimet e përcaktuara për të krijuar të ardhura dhe flukse monetare të ardhshme. Vetëm shpenzimet që sjellin një aktiv të njohur në pasqyrën e gjendjes financiare janë të vlefshme për t’u klasifikuar si aktivitete investuese. Gjatë kësaj periudhe kompania ka investuar në aktive afatgjatë material me vlerë 533,996 lekë për përmirësimin e ambienteve ekzistuese.

3.3.3 Aktivitetet financuese

Flukset monetare që krijohen nga veprimtaritë financiare janë të rëndësishme pasi ato shërbejnë për parashikimin e kërkesave për fluksin monetar të ardhshëm nga ofruesit e

kapitalit për njësinë ekonomike. Gjatë periudhës ushtrimore, shoqëria është financuar duke marrën një hua nga pronari.

Hartuesi i pasqyrave

Ersi NGJELA



Drejtore i përgjithshëm

Shefikat NGJELA

